



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:271371

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05458457

P.nr. 18/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit V. B., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5396/2023, të datës 22.01.2024, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar të hapur për publikun, të mbajtur me datë 12.03.2024, në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Menduhi Kastrati, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. M. H., me datë 13.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

V. B., nga i ati Xh. dhe nëna R., e gjinisë H., data e lindjes ..., me vendbanim në lagjen ..., P., ka të kryer Fakultetin Teknik në Gj., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, letërnjoftimi ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Deri me datën 20.08.2023, rreth orës 22:00, në rrugën “...”, në P., me dashje e vetëdije e në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit 05/L-022 për armë, pa autorizim posedon armën, në atë mënyrë që ditën kritike derisa njësia policore gjatë punës rutinore në një pikë kontrolli kanë ndaluar të pandehurin V. B., i cili e drejtonte veturën e tipit “M.”, ngjyrë të ..., dhe gjatë kontrollit në trupin e të njëjtit i është gjetur një sprej i cili është konfiskuar me vërtetim mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve.

- me këtë ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së si dhe neneve 364, 365, 367, 449 dhe 452 par. 1 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro, të cilën detyrohet ta paguajë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

II. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në shumën e përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguaj shumë prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit po ashtu shumë prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

IV. KONFISKOHET: ... (...) sprej për sy, ngjyrë e ..., si mjet i kryerjes së veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.5396/2023, të datës 22.01.2024, kundër të pandehurit V. B., për shkak të veprës penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.03.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtit i ofrojë mundësinë e deklaramit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, shprehu keqardhje për rastin e ndodhur, premtoi se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, nga gjykata kërkoi një dënim sa më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimi të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë është në përputhshmëri me dispozitat e nenit 242 të KPP-së, i propozoi gjykatës që të me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Mbrojtësi i të pandehurit av. M. H., është pajtuar me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pranimi i fajësisë është bërë në konsultim të mjaftueshëm me të si mbrojtës, andaj kërkoi nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit si rrethana lehtësuese për të pandehurin të merr parasysh

pranimin e fajësisë, keqardhjen e shprehur, dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimin e tij, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, se nuk ka qenë i dënuar më parë, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara vlerësoi se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin e armës është marrë në bazë të nenit 366 par. 3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 18/24, Datë 15.03.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.